



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: BOE i Operatorëve ekonomik "CLIMACASA" shpk & AL-TEK shpk
Adresa: Lezhe Lagjja Beslidhja, Rruga Shtraus, Pallat i ndertuar nga
Shoqeria "JUNIK", Kati 1, Njesia Nr.10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim" "Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjeteve hidraulike, ngrohje-ftohje kaldaja, kondicionerë dhe pajisje të tjera për vitin 2019".

Referenca e procedures: Nr.reference REF-38015-10-02-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjeteve hidraulike, ngrohje-ftohje kaldaja, kondicionerë dhe pajisje të tjera për vitin 2019".

Fondi limit: 4,166,666 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të VKB Nr. 159, datë 21.12.2018, për "Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019".

Afati i kryerjes së shërbimit: Mirëmbajtja e rrjeteve hidraulike do të kryhet për një periudhë kohore 1 (një) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.10.2019 ora 11.00

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 datë 07 Tetor 2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë-

1. BOE i Operatorëve ekonomik “CLIMACASA” shpk & AL-TEK shpk

NUIS L07805502F dhe NUIS K48130519Q

Vlera e ofertës – 3.125.000 leke pa tvsh (tre milion e njëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “ALTEC” shpk

NUIS K57923807Ë

Vlera e ofertës – 3.131.290 (tre milion e njëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” shpk

NUIS K01529003M

Vlera e ofertës – Vlera e ofertës- 0 lekë

Operatorët ekonomikë të s’kualifikuar janë si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik “ALTEC” shpk

NUIS K57923807W

Arsyet e s’kualifikimit:

1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8 ”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ”Kapaciteti ekonomik dhe financiar” (modifikuar nga autoriteti kontraktor), pika 3.2 gërma (c) është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

”Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR”.

Nga verifikimi në S.P.E (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Altec” shpk rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga operatori ekonomik sa më sipërcituar janë paraqitur:

- 1. Vërtetimi i datës 03.05.2019 me nr A-6660/1 Prot lëshuar nga Bashkia Tiranë, sipas së cilës shoqëria “Altec” shpk ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019.*

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Altec” shpk, në rubrikën “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit” rezulton se aktualisht kjo shoqëri ka selinë në Fier dhe ushtron aktivitet edhe në Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Altec” shpk nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranës dhe nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Fier ku ai rezulton të jetë operativ dhe ka edhe Selinë.

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të

kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Në vijim në Nenin 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikohet se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në pikën 6 të këtij neni citohet gjithashtu se: “Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

2. Në pikën 2 të kapacitetit teknik në DST është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një numër punonjësish prej të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) personave**, nga të cilët duhen,

- Minimumi 2 (dy) elektrikiste
- Minimumi 1 (një) specialist kondicionimi
- Minimumi 2 (dy) instalues termoteknike
- Minimumi 2 saldatore
- Minimumi 1 specialist hidraulik

të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të konfirmuara nga autoritetet përkatëse dhe për të cilët duhet të paraqiten deshmi kualifikimi që vërtetojnë se janë trajnuar për instalimin e kondicionereve të kërkuar nga AK, deshmi këto të cilat janë të leshuara nga një trup certifikues, i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar.

Operatori ekonomik për të plotësuar këtë kriter ka paraqitur:

Dokumentacion për, 2 (dy) elektrikiste: Adriatik Vishi me certifikate nga D.Formimi profesional dhe Albano Aliaj vertetuar me deshmi kualifikimi

Për 1 (një) specialist kondicionimi: Leonard Citozi me certifikate nga D.Formimi profesional dhe Fatmir Malaj me certifikate nga D.Formimit Prof për kondicionere shtepie

Për (dy) instalues termoteknike: Lulezim Hoxhalli dhe Sokol Meraj me certifikate nga D.Formimit Profesional për instalues dhe riparues impjante ngrohje ftohje

Për 2 (dy) saldatore: Jetmir Kaca dhe Agim Kurcani me certifikate kompetence nga CCI
Për 1 (një) specialist hidraulik: Indrit Xhumri me deftese pjekurie nga shkolla Karl Gega

Për stafin e punonjësve të kërkuar, sipas pikës 2 të DST konkretisht për: 1 (një) elektrikist (A.V); 1 (një) specialist kondicionimi (L.C); 2 (dy) instalues termoteknike (L.H dhe S.M); 1

specialist hidraulik (I.XH), nuk janë paraqitur deshmi kualifikimi që vërtetojnë se janë trajnuar për instalimin e kondicionereve të kërkuar nga AK, deshmi këto të cilat të jete të leshuara nga një trup certifikues, i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar.

3. Në pikën 3/ a, **të kapacitetit teknik në DST është kërkuar:** Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) stafin përgjegjës (Drejtuesit teknik) që do të merren me realizimin e shërbimeve dhe që do të jete të pranishëm në objekt gjatë kohës së kryerjes së këtyre shërbimeve për sa më poshtë vijon:

- Inxhinier mekanik. 1 (një)
- **Inxhinier elektrik. 1(një) (Punime elektrike)**
- Inxhinier ndërtimi. 1(një) (Punimet ndërtimore).
- Inxhinier elektronik,1(një) (i nevojshem për rikonfigurim nga ana elektronike i të gjithë sistemit në teresi)

Dokumentacioni provues për stafin inxhinierik:

- Diplome,
- Kontrate pune përkatëse (e vlefshme)
- Të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi të konfirmuara nga autoritet përkatëse.

Operatori ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka deklaruar se Inxhinier elektrik do të jetë Ing. Besmir Osmenaj.

Për stafin mbështetës të kontratës, sipas pikës 3/ a, OE ka deklaruar se drejtues teknik do të jete Ing. (B.O), i cili është i diplomuar për inxhinieri informatike dhe jo elektronike sikundër është kërkuar në dokumentet standarte të tenderit pika 3 e kapacitetit teknik dhe nuk figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik.

4. Në pikën 5 **të kapacitetit teknik në DST është kërkuar: Disponimi i mjeteve të mëposhtme:** Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton (një copë); Saldatrice (dy copë); Matrapik (dy copë).

Për disponimin e mjeteve, sipas pikës 5 të DST-së, konkretisht “Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton”, kapaciteti total mbajtës i mjetit të deklaruar (është 910 kg); “Saldatrice (dy copë), nuk ka paraqitur dokumentacion provues për 1 mjet saldatrice; për mjetin “Matrapik (dy copë), nuk ka paraqitur dokumentacion provues për 1 mjet matrapik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Sulollari Klima” është s’kualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **Operatori ekonomik “Sulollari-Klima”** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“Sulollari-Klima” s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE i Operatorëve ekonomik “CLIMACASA” shpk & AL-TEK shpk** me adresë: Lezhe Lagjja Beslidhja, Rruga Shtraus, Pallat i ndertuar nga Shoqëria "JUNIK", Kati 1, Njesia Nr.10 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.125.000 leke pa tvsh (tre milion e njëqind e njëzetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 13.11.2019.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.